

## NË EMËR TE POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega në Kaçanik, Departmenti I Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Shabi Idrizi , Sek. Juridike Shpresa Hoxha , në qështjen penale të akuzurëve [REDACTED] nga f. [REDACTED] K-Kaçanik dhe [REDACTED] nga f. [REDACTED]-Hani Elezit të akuzuar se në bashkryrje kanë kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par 2 të KPK-së, sipas aktakuzës të PTH-Ferizaj, PP/II.1994-4/14, të datës 13.01.2015 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, oral dhe publik me datën 13.12.2016, në prani të përfaqësuesit të PTH-Ferizaj Agim Kuka, dëshmitarit [REDACTED] dhe të akuzuarëve A [REDACTED] dhe [REDACTED] muarr dhe shpalli këtë;

## A K T G J Y K I M

### Të akuzuarit;

1. [REDACTED] nga f. [REDACTED] K-Kaçanik i lindur me [REDACTED] në f. [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë, [REDACTED], shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, prind i 3 fëmijëve, i gjendjes së varfër ekonomike,,I papunë , I denuar edhe më parë, NP-[REDACTED] në vuajtje të denimit.
2. [REDACTED] nga f. [REDACTED] K-Hani Elezit i lindur me [REDACTED] në f. [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, , i gjendjes së varfër ekonomike,,I papunë , kinse I padenuar më parë, NP-[REDACTED] mbrohet në liri

### JANË FAJTOR

Se me dt. 07.08.2014 rreth orës 15,20 në pyllin shoqëror të cilin e menaxhon Autoriteti pyjor Komunal në Kaçanik, në rajonin ekonomik pyjorë Bodoshnjak, në vendin e quajtur "Ara e Arifit ", me qëllim vjedhje kanë prerë 18 drunë të llojit ahu -shkoze me diametër 43-54 cm , lartësi prej 13-41 , gjithsejte në kubaturë prej 5.59 m, kub , vlere e dëmit të shkaktuar është 769.05 € të cilat drunëj i ka bartur me kuaj,-

Me këtë veprim në bashkryrje kryen veprën penale Vjedhje pylli nga neni 358 parg. 2 të KPK-së

Andaj gjykata duke u bazuar me dispozitat e nenit 3, 11, 15, 41, ,46,50.51,neneve 73,75, të KPK dhe nenit 365 , 453 dhe 463 të KPPK-së i

## GJYKON

1.Të pandehurit [REDAKTUAR] i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 90 ditëve i cili nuk do ekzekutohet poqëse në afat prej 1 viti pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimit (koha e verifikimit) nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale dhe dënim me gjobë në shumë prej 300,00 € të cilën do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe atë në 3 këste mujore.

2.Të pandehurit [REDAKTUAR] i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 90 ditëve dhe dënim me gjobë në lartësi prej 150 euro i cili nuk do ekzekutohet poqëse në afat prej 1 viti pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi (koha e verifikimit) nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale .

Udhëzohet e dëmtuara që kërkesën e vet pasuroro-juridike ta realizoj në kontest civil.

Obligohen të pandehurit që në emër të shpenzimeve procedurale të paguajnë shumën në lartësi prej 50.00 € solidarisht.

## A r s y e t i m

PTH nga Ferizaji, me aktakuzën PP/II.1994-4/14, të datës 13.01.2015, të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], i ka akuzuar për shkak veprës penale në bashkveprim vjedhje pylli nga neni 358 par 2 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Në shqyrtimin gjyqsor Prokurori shtetror pranë PTH-Ferizaj Agim Kuka në fjalën përfundimtare mbeti në tërsi pranë aktit akuzues të paraqitur me shkrim pranë kësaj gjykate pa ndryshime dhe plotsime, duke propozuar gjykatës që të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] të i shpall fajtor për veprën penale që akuzohen dhe tui shqiptojdenim meritor sipas ligjit, ngase gjendja faktike dhe kulifikimi juridik si në dispozitivin e aktakuzës u vertetua sot në shqyrtimin gjyqsor nga deklarimi i deshmitarit [REDAKTUAR] por edhe nga pranimi i pjeshëm i fajsisë nga ana e të akuzuarëve . Njiherit i ka propozuar gjykatës që gjatë matjes dhe shqiptimit së denimit ti ketë parsysh si rrethanat lehtsuese pranimin e pjeshëm fajsisë , gjendjen e veshtirë ekonomike , por edhe ato renduese recidivizimin e veprimeve të akzuarit të parë.

I akuzuari [REDAKTUAR] në mbrotjen e tij në shqyrtimin gjyqsor në tërsi e ka mohuar kryerjen e veprës penale që i veket në barrë dhe i propozon gjykatës që ta leroj nga përgjegjsia penale ngase ai ka marrë vetëm drunj të thatë e kurrsesi nuk ka prerë drunj të njomë.

I akuzuari [REDAKTUAR] në mbrotjen e tij në shqyrtimin gjyqsor në tërsi e ka mohuar kryerjen e veprës penale që i veket në barrë dhe i propozon gjykatës që ta leroj

nga përgjegjsia penale ngase ai ka ndihmuar të akuzuarin [REDACTED] dhe se kanë marrë vetëm drunj të thatë e kurrsesi nuk kanë prerë drunj të njomë.

Në procedurën e provave gjykata bëri degjimin e dëshmitarit , [REDACTED] , rojtar pylli pranë [REDACTED] në Han të Elezit i cili deklaroi njerëzsi si në përmbajtjen e proceqverbalit me nr135/14 të dt. 14.08.2014 dhe se deklaroi se janë të njerëzsi persona që e ka takuar në vendngjarje në datën kritike, kui akuzuari i pare është i njohur për recidivizëm, ndërsa i akuzuari i dytë ishte hera e parë që e shihte duke marrë drunj .

Mandej Gjykata ka bere leximin e provave materiale proqesverbalet e lartëcekura të përpiluar nga rojtari i pyllit dëshmitari i lartpërmendur [REDACTED]

Gjykata ka bere vlersimin e provave te shqyrtuara nje nga nje dhe te gjitha sbashku dhe ka konstatuar kete gjendje faktike; me dt. 07.08.2014 rreth orës 15,20 në pyllin shoqëror të cilin e menaxhon Autoriteti pyjor Komunal në Kaçanik, në rajonin ekonomik pyjor Bodoshnjak, në vendin e quajtur "Ara e Arifit ", me qëllim vjedhje kanë prerë 18 drunë të llojit ahu –shkoze me diametër 43-54 cm , lartësi prej 13-41 , gjithsejte në kubaturë prej 5.59 m, kub , vlera e dëmit të shkaktuar është 769.05 € të cilat drunëj i ka bartur me kuaj,-

kjo vertetohet ngas deklarata e dëshmitarit [REDACTED] i cili deklaroi se të akuzuarit i kishte takuar në vendin e lartpërmendur si në dispozitivin e aktit akuzues dhe se aty ka qenë të njerëzsi persona që sot janë në shqyrtim porse njiherit kjo terthorazi vertetohet edhe nga deklarata e vet të akuzuarëve të cilët deklarojnë se kjo është e vërtetë porse kanë prerë dru të thata e jo të njoma.

Gjykata ka vlersuar se në veprimet e të akuzuarëve ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale vjedhje pylli në bashkëveprim nga neni 358 parag 2 lidhur me nenin 31 të KPK-së, për të cilën vepëra i akuzuari është penalishtë përgjegjës dhe është ndeshkuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Ky vlersim është i bazuar në pranimin e pjeshëm të fajsisë nga ana e të akuzuarëve , dëshmia e dëshmitarit [REDACTED] porse edhe nga provat materiale si Proceqverbalet nga vendi i ngjarjes i bërë nga ana e rojtarit të pyllit ku vertetohet plotsisht se me datën e lartëcekura të akuzuarit kanë kryer veprën penale siq është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjës së denimit gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 75 i KPK-së të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit gjykata ka marrë për bazë; pranimin e pjeshëm të fajsisë gjendjen ekonomike të akuzuarëve, , sjelljen e mirë të tyre gjatë tërë procedurës si dhe në shqyrtimin gjyqsor , ndërsa rrethanë rënduese se kjo vepër penale është dukuri e shpeshë dhe mjaftë e përhapur .



Gjykata është e bindur se denimi i shqiptuar ndaj të akuzuarëve është në harmoni me shkallën e përgjegjësive penale të tyre dhe peshën e veprës penale, kështu që denimi i shqiptuar në lartësi si në dispozitivin e aktgjykimit do arrihet qëllimi i denimit i parapaprë me nenin 41 të KPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPK-së.

Vendimin që të udhëzohet palën e demtuar për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike në procedurë kontestimore është i bazuar në nenin 463 të KPPK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
Dega në Kaçanik  
P. nr. 28/15 ,me dt. 13.12.2016

Sek. Juridike,  
Shpresa Hoxha

Gjyqtari  
Shabi Idrizi



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, pala e përkrahur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

